



RAPORTI VJETOR

2019

**Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
SHÇBA**

www.shcba.gov.al

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm të SH.Ç.B.A-së



Të nderuar lexues,
Është kënaqësia ime, që për të dytin vit radhazi, në kuadër të transparencës me publikun t'ju prezantoj Raportin Vjetor të Punës së SHÇBA për vitin 2019. Gjatë vitit që lamë pas, Shërbimi ka vijuar përpjekjet në përmbushje të misionit të tij për garantimin e zbatimit të ligjit, mbrojtjen e interesave të ligjshëm të shtetit, si dhe të drejtave të shtetasve, nga veprimet dhe mosveprimet e kundërligjshme të punonjësve të strukturave, pavarësisht nga funksioni dhe grada.

Programet e Qeverisë dhe të Ministrisë së Brendshme për vitin 2019 në gjithë kompleksitetin e tyre në interes të integritetit të Shqipërisë në BE, ligjit organik të Shërbimit nr. 70/2014 për “Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme” si dhe të ligjit mbi procesin e Vetëqëllimit 12/2018, kanë qënë tepër nxitëse dhe motivues për të ndërmarrë nisma reformatore për përmirësimin e performancës së Shërbimit me një këndvështrim tjetër filozofik e

juridik për të plotësuar e përmbushur misionin ligjor dhe ushtruar mbikqyrjen e jashtme ndaj strukturave, objekt i veprimtarisë së Shërbimit.

Në këtë raport pasqyrohen masat afatshkurtra dhe afatmesme të ndërmarrë për riaktivizimin dhe ngritjen e kapaciteteve të brendshme të Shërbimit, projektet dhe reformat afatgjata të inicuar gjatë këtij viti, me synim reformimin tërësor të Shërbimit dhe shndërrimin e tij bazuar në standardet e zhvillimit institucional me ato të Partnerëve Evropianë Kundër Korrupsionit (EPAC).

Gjithashtu, gjejnë pasqyrim treguesit kryesorë të veprimtarive të strukturave kyçe të Shërbimit, të arritura gjatë vitit 2019, si në aspektin e hetimit administrative të ankesave dhe inspektimeve ashtu edhe në hetim penal të shkeljeve të ligjit, nga punonjës të strukturave. Pasqyrohet angazhimi ndërinstitucional i Shërbimit, përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga dokumentat strategjike ndërinstitucionale dhe planeve konkrete të veprimit, në kuadër të proceseve integruese të vendit tona në Bashkimin Europian. Gjen pasqyrim veprimtarisë e strukturave të shërbimeve mbështetëse dhe sektorit të financës së Shërbimit ashtu si dhe prioritetet, objektivat dhe synimet tona për vitin 2020 e në vazhdim.

Vizioni ynë është shndërrimi i Shërbimit në një agjenci ligjzbatuese efektive që mbështetet në inovacionin teknologjik, angazhimin proaktiv në luftën kundër fenomeneve negative që prekin strukturat subjekt i veprimtarisë, si edhe në integritetin dhe profesionalizmin e shfaqur nga specialistët tanë, në çdo etapë të hetimeve të kryera.

Intesifikimi i punës sensibilizuese të publikut për denoncimin e shkeljeve të ligjit nga punonjësit e strukturave, nëpërmjet fushatave promovuese dhe transparencës përmes publikimit të treguesve dhe rezultateve të arritura nga hetimet administrative të ankesave në mënyrë periodike, do të vazhdojë të jetë një nga objektivat tanë kryesorë edhe për vitin 2020.

Në emër të stafit të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, falenderoj publikun për mbështetjen që kanë dhënë për përmbushjen e misionit tonë, përmes bashkëveprimit dhe mbikqyrjes së jashtme qytetare në funksion të zbatimit të ligjit nga strukturat e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe shërbimit Zjarrfikës.

Shpresoj që ky Raport të ndihmojë në rritjen dhe forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit Shërbim – publik, përmes informimit dhe transparencës me qytetarët.

Muhamet Rrumbullaku

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

PASQYRA E LËNDËS

I.	FJALA PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHÇBA-SË	2
II.	VLERËSIMI I MJEDISIT DHE MASAT E MARRA PËR PËRMIRËSIM	5
III.	PROJEKTET DHE REFORMAT E NDËRMARRA NË VITIN 2019	6
IV.	VEPRIMTARIA E STRUKTURAVE TË INSPEKTIMIT DHE TRAJTIMIT TË ANKESAVE	7
	III.1. Trajtimi dhe Shqyrtimi Administrativ i Ankesave	
	III.1.1. Funksionimi i Linjës së Gjellbër	
	III.1.2. Administrimi i Ankesave	
	III.1.3. Ankesa sipas Objektivit dhe Përfundimit të Hetimeve Administrative	
	III.2.VEPRIMTARIA INSPEKTUESE	
	III.2.1 Dinamika e Inspektiveve për Vitin 2019	
	III.2.2 Inspektive të Planifikuara	
	III.2.3. Inspektive të Paplanifikuara	
	III.2.4. Inspektive për Trajtim Ankesash	
V.	VEPRIMTARIA E STRUKTURAVE TË DREJTORISË SË HETIMIT PENAL.....	13
	IV.1. Fenomenet	
	IV.2. Hetimi Procedural Penal	
	IV.3. Disa nga operacionet për zbulimin dhe goditjen e “kultivimit” dhe shkeljeve të tjera nga punonjës të strukturave	
VI.	VEPRIMTARIA E SHÇBA NË FUSHËN E VERIFIKIMIT TË PASTËRTISË SË FIGURËS.....	18
	V.1. Mbikqyrja nëpërmjet veprimtarisë së Vettingut	
VII.	VEPRIMTARIA E SHÇBA NË FUNKSION TË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE SEKTORI I FINANCËS.....	19
	VI.1. Rekrutimet, emërimet, transferimet, lirimet nga detyra	
	VI.2. Edukimi, trajnimi i personelit	
	VI.3. Masat disiplinore	
	VI.4. Ecuria në karrierë (gradë)	
	VI.5. Sektori i Buxhet-Financës	
	VI.6. Aktivitete brenda dhe jashtë vendit të SHÇBA	
	VI.6.1 Angazhime dhe aktivitete brenda vendit	
	VI.6.2 Angazhimi në aktivitete jashtë vendit	
VIII.	PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT E SHÇBA-SË PËR VITIN 2020.....	22

I. VLERËSIMI I MJEDISIT DHE MASAT E MARRA PËR PËRMIRËSIM

Viti 2019, pikërisht në muajin Janar, për SHÇBA-në filloi me një ndryshim në Drejtuesin e këtij institucioni, i pasuar edhe me ndryshime të tjera të stafit drejtues, me dy Zv/Drejtorë të Përgjithshëm dhe drejtor drejtorie në nivel qendror dhe vendor.

Nisur nga objektivat, synimet dhe këndvështrimi i një Drejtuesi të ri të Shërbimit, pikësëpari, u fokusa puna në njohjen e Shërbimit, në të gjitha aspektet si; *korniza ligjore që normon veprimtarinë e tij; organizimi strukturor dhe funksional; kompetencat dhe përgjegjësitë institucionale dhe funksionale të Shërbimit; agazhimet ndërinstitucionale brenda dhe jashtë vendit të Shërbimit; njohjen e vetë personelit të Shërbimit atij në nivel drejtues dhe atij operacional/zbatues; njohjen e kapaciteteve dhe burimeve financiare e logjistike të Shërbimit* etj. Ky proces u mundësua bazuar edhe në dy dokumente mjaft të rëndësishëm, njëri i vlerësimit të jashtëm dhe tjetri i vlerësimit të brendshëm të Shërbimit.

Vlerësimi i jashtëm

- Duke u bazuar në Standardet e Partnerëve Evropiane Kundër Korrupsionit, dokument i përgatitur nga ICITAP në bashkëpunim edhe me drejtues e punonjës të vetë Shërbimit.

Vlerësimi i brendshëm

- Dokumenti “*Vlerësimi dhe Gjetjet mbi veprimtarinë e SHÇBA-së 2018*”, i përgatitur nga një grup pune, me drejtues e ekspertë sipas fushave të veprimtarisë së Shërbimit.

Emëruesi i përbashkët i dy dokumenteve, për një periudhë afatshkurtër, u fokusua në:

Implementimin e Strukturës dhe Përbërjes së re Organike të Shërbimit. Kjo situatë krijoi siguri në personelin e Shërbimit, si dhe rriti përgjegjshmërinë në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësiwe institucionale dhe funksionale.

Hartimin e Dokumenteve bazë të Planifikimit Vjetor të Punës së Strukturave të Shërbimit, sipas parashikimeve të Ligji organik nr. 70/2014:

Programi Vjetor Viti 2019 – i miratuar nga Ministri i Brendshëm
Plani Vjetor i Punës viti 2019 – i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm

Vënien në efijencë të strukturave të Shërbimit, nëpërmjet hartimit dhe ndjekjes së planeve konkrete të veprimit, në fushën e veprimtarisë informativo - gjurmuese, hetimore dhe asaj operacionale.

Orientimin dhe drejtimin e veprimtarisë së Strukturave të Hetimit të Shërbimit, drejt problematikave kryesore apo fenomene të evidentuara në rradhët e strukturave, subjekte të Shërbimit, në veçanti të Policisë së Shtetit, për paligjshmëri dhe abuzim me detyrën, bazuar në treguesit e vitit 2018, por dhe nga vetë raportet vjetore të strukturave vendore dhe qendrore të Policisë.

Plotësimin e akteve normative të Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm, me qëllim përmirësimin e problematikave dhe mangësive të evidentuara gjatë veprimtarisë së strukturave vendore dhe qendrore të Shërbimit në aspektin e organizimit, funksionimit, përmbushjes së përgjegjësiwe institucionale, ligjore e funksionale. Në këtë kontekst, u nxorrën aktet e mëposhtme normative:

1 Udhëzim & 1 Urdhër i Ministrit të Brendshëm

15 Urdhra të Drejtorit të Përgjithshëm,

5 Qarkore të Shërbimit,

1 Përgjithësim mbi përvojën pozitive të Operacioneve të Përbashkëta me Policinë e Shtetit.

3 Marrëveshje Bashkëpunimi me Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë.

II. PROJEKTET DHE REFORMAT E NDËRMARRA NË VITIN 2019

Masat e situatës së emergjencës në 3 mujorin e parë të vitit 2019, ndihmuan jo vetëm në njohjen e gjendjes dhe eliminimin e indikatorëve të rrisht, kryesisht në plotësimin e burimeve njerëzore, por dhe në garantimin real të stabilizimit në marrëdhëniet e punës për gjithë punonjësit duke kërkuar angazhimin maksimal të tyre në realizimin e detyrave funksionale.

Gjithsesi, kjo kohë ishte e mjaftueshme për të projektuar reformat më të thella në aspektet më kryesore të Shërbimit si ato të karakterit legjislativ, strukturor, burimet njerëzore, çështjet llogjistike, financiare, akomoduese e çdo gjë tjetër që ishte në interes të standardeve, projektimi i të cilave do të shtrihej në afate të gjata kohore dhe kërkonte domosdoshmërisht

hartimin e një dokumenti stragjik afatgjatë. Në këtë kuadër u hartua për herë të parë në historinë e Shërbimit:

❖ *Dokumenti i Strategjisë për Zhvillimin e SHÇBA-së, 2020 – 2024 dhe Plani i Veprimit, 2020-2022, i cili është në proces miratimi me Vendim të Këshillit të Ministrave.*

❖ *Projekt - ligjin e ri të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, së bashku me paketën e akteve ligjore dhe nënligjore në zbatim të tij.*

❖ *Struktura dhe përbërja organike e Shërbimit, rishikimi i saj, nxori domosdoshmëri, përveç problemeve të burimeve njerëzore, edhe riformatimin e dislokimit të SHÇBA-së, në nivelin vendor, për shkak edhe të përgjegjësisë që vuri ligji nr. 12/2018, për procesin e vettingut, ku Shërbimi u përcaktua si autoritet Vlerësues dhe jo vetëm Verifikues.*

❖ *Përmirësimi i kapaciteteve të Burimeve Njerëzore, me objekt zhvillimin e Hetimeve Procedurale Penale dhe kryerjen e Inspektimeve ndaj fenomeneve dhe akteve korruptive. Ky projekt është ende në proces.*

❖ *Projekti për të krijuar “Kapacitete të qëndrueshme Poligrafi në SHÇBA”.*

Ky projekt është pjesë e asistencës për reformën në sistemin e drejtësisë penale të ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare, ku SHBA po investon një sërë masash anti-korrupsion. **Spektori do të kryej detyrën e Poligrafit si pjesë e procesit të Testit të Integritetit për aplikantët dhe punonjësit e konfirmuar në Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH)**, që është pjesë e Strukturës Antikorrupsion dhe kundër Krimin të Organizuar. Ekspertë të SHÇBA-së, gjithashtu do të kryejnë ekzaminime poligrafi për punonjësit e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, në zbatim të:

- ✓ *Ligjit 70/2014 “ Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme”,*
- ✓ *Ligjit Nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”,*
- ✓ *Ligjit Nr. 12/2018 “ Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe SH.Ç.B.A-së”(i ndryshuar).*

Në muajin Nëntor 2019 ICITAP i dhuroi Ministrisë së Brendshme pesë sete pajisjesh për ekzaminimin poligrafik si dhe certifikimin e 5 ekspertëve të parë të poligrafit në Shqipëri.

III. VEPRIMTARIA E STRUKTURAVE TË INSPEKTIMIT DHE TRAJTIMIT TË ANKESAVE

III.1 Trajtimi dhe Shqyrtimi Administrativ i Ankesave

Dinamika e ankesave gjatë vitit 2019 paraqitet si vijon më poshtë:



III.1.1 Funksionimi i Linjës së Gjelbër

Gjatë vitit 2019 nga Sektori i Ankesave janë marrë **6342 telefonata** nëpërmjet **Linjës së Gjelbër 08009090**, konkretisht:

- **1549 telefonata** kanë qenë brenda objektit të punës së SHÇBA-së dhe nëpërmjet strukturave të Shërbimit në nivel qendror dhe vendor si dhe strukturave vendore të policisë, është kontaktuar menjëherë telefonuesi duke i dhënë zgjidhje problemit të ngritur.
- **1288 telefonata** kanë qenë jashtë fushës së veprimtarisë së SHÇBA-së dhe shtetasve u është dhënë informacioni i kërkuar dhe janë adresuar pranë strukturës përkatëse ku duhet të depozitohen ankesën e tyre.
- **3505 telefonata** kanë qenë me objekt informacion në lidhje me veprimtarinë e SHÇBA-së.

III.1.2 Administrimi i Ankesave

Në nivel qendror dhe vendor janë administruar **1731 ankesa** nga të cilat **78.1%** e ankesave kanë ardhur pranë Shërbimit drejtpërdrejt nga qytetarët dhe **21.9%** në mënyrë indirekte e konkretisht:


Ankesa të ardhura pranë Shërbimit, drejtpërdrejt nga qytetarët:

- **25.3%** e ankesave përmes telefonatave në linjën e gjelbër;
- **13.4%** e ankesave nëpërmjet paraqitjes së qytetarëve pranë Zyrës së Ankesave;
- **15.6%** e ankesave nëpërmjet adresës së e-mailit ankesa@shcba.gov.al;
- **10.1%** e ankesave nëpërmjet postës;
- **13.6%** e ankesave të marra nga strukturave Rajonale të SHÇBA-së.

Ankesa të ardhura pranë Shërbimit, nëpërmjet palëve të tjera:

- **15.1%** ankesa nëpërmjet aplikacionit “Komisariati Digital”
- **4.9%** ankesa nëpërmjet nga institucioneve të ndryshme;
- **1.9%** ankesa janë administruar nëpërmjet publikimeve në media.

Më poshtë paraqitet skema e të dhënave:



III.1.3 Ankesa sipas Objektivit dhe Përfundimit të Hetimeve Administrative

Nga administrimi i ankesave dhe hetimi administrativ i tyre ka rezultuar se:

- **27.3 %** janë ankesa jashtë objektivit të veprimtarisë së SHÇBA-së
- **72.6 %** janë ankesa brenda objektivit të veprimtarisë së SHÇBA-së nga të cilat:
 - ✓ 77% ankesa janë të pazhuara ose nuk është arritur të provohen.
 - ✓ 23% ankesa, janë të pazhuara


Nga trajtimi i ankesave në tërësi gjatë periudhës analizuuese, ka rezultuar se;

- Në **1 rast**, për **3 punonjës policie janë gjetur shkelje ku janë konstatuar elementë të veprës penale**, duke bërë referimin e materialeve pranë organit të Prokurorisë, për punonjësin objekt të ankimimit.
- Në **118 raste**, për **215 punonjës policie janë gjetur shkelje të karakterit administrativ**, duke sugjeruar fillimin e hetimit disiplinor nga Drejtoria e Standardeve Profesionale në Policinë e Shtetit, për punonjësin objekt ankimimi;

- Në rastet e tjera, veprimet e punonjësve kanë qenë konform rregullave dhe Procedurave Standarde të Punës.

Sipas Shërbimeve të policisë, pas përfundimit të hetimeve ka rezultuar se punonjësit që kanë kryer shkelje dhe i janë rekomanduar Drejtorisë së Standardeve Profesionale për fillimin e hetimit disiplinor, i përkasin:


- ✓ **39.6%** strukturave të Policisë Rrugore,
- ✓ **28.3%** strukturave të rendit,
- ✓ **15.3%** strukturave të hetimit të krimit,
- ✓ **12%**, niveleve menaxheriale (*shef komisariati, shef stacioni policor, shef sektori/seksioni*),
- ✓ **3.8%** strukturave të kufirit
- ✓ **1%** strukturave të Forcës Operacionale/Posaçme



Grafiku i mësipërm tregon se numri më i madh i ankesave i përket shërbimeve të policisë të cilët kanë kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarin siç janë strukturat e Policisë Rrugore, Sigurisë Publike apo Hetimit të krimit.


Sa sipër, trendi i shkeljeve të denoncuar nga publiku, kryesisht për mosveprim të strukturave të policisë, shkeljes së procedurave standarde të punës, sjelljet jo etike, apo vendosja jo e drejtë e gjobave për drejtuesit e mjeteve, reflektohet në numrin më të lartë të punonjësve për të cilët është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor, sipas strukturave përkatëse. Të ndara sipas strukturave policore për të cilat janë bërë ankesat, gjendja paraqitet si vijon:

Dinamika sipas strukturave



Nisur nga grafiku i mësipërm, numri i lartë i ankesave sipas kësaj ndarje lidhet me numrin më të lartë të popullsisë së përqendruar në këto qarqe, me vetë numrin e punonjësve të policisë, me dinamikën e jetës tepër aktive si dhe problematikat që hasen nga strukturat e Policisë së Shtetit janë më të shumta në numër dhe në shumëllojshmëri. Varësisht këtyre elementëve edhe propabiliteti i “përplasjeve” e “pakënaqësive” të publikut apo dhe “mundësisë së abuzimit” nga punonjësit e këtyre strukturave të jetë më i lartë.


Të ndara sipas tendencës së shkeljeve të raportuara gjendja paraqitet si vijon:



Sipas treguesve statistikor të paraqitur në këtë grafik rezulton se trendi i shkeljeve të mundshme të kryera nga punonjësit e strukturave, të adresuara nëpërmjet denoncimeve të publikut pranë SHÇBA-së, vazhdon të jetë mosveprimi i strukturave, shkelje e procedurave standarde të punës, veprime arbitrare si dhe shpërdorim detyrë.

Krahasuar edhe me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ky trend rezulton të jetë pothuajse në të njëjtat vlera, siç evidentohet edhe në grafikun e mëposhtëm, me përjashtim të shkeljes “mosveprim” që ka pësuar një ulje të dukshme, edhe pse natyra e këtyre ankesave ka bërë kryesisht me zgjidhje konfliktesh të llojeve të ndryshme, të zakonshme në jetën komunitare.

Shkeljet e raportuara krahasuar me vitin 2018



III.2 VEPRIMTARIA INSPEKTUESE

III.2.1 Dinamika e Inspektimeve për Vitin 2019

Gjatë vitit 2019, nga Sektori i Inspektimit janë zhvilluar **73 inspektime** në **116 struktura** subjekte të Shërbimit e konkretisht:


- ✓ **10** inspektime të planifikuara në planin vjetor për vitin 2019
- ✓ **63** inspektime të paplanifikuara të cilat janë iniciuar nga ngjarjet e ndodhura, publikimet në media dhe problematika të raportuara nga qytetarë ose institucione të ndryshme, nga të cilat **13 inspektime** të përbashkëta si vijon:
 - **11 me Drejtorinë e Hetimit të SHÇBA-së**
 - **2 me Drejtorinë e Standardeve Profesionale në DPPSH.**
- ✓ Kryer veprimet procedurale për **2** procedime penale në ndjekje nga viti 2018.

Në përfundim të veprimtarisë inspektuese:

Janë referuar materialet procedurale në Prokurori për **9 (raste)** në ngarkim të **35 personave** nga të cilët: *20 punonjës policie; 14 shtetas dhe 1 nëpunës publik.*

- ✓ Janë dhënë **181** rekomandime për përmirësim të problematikave të evidentuara.
- ✓ Sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor për **281** punonjës të Policisë së Shtetit dhe **5** punonjës të Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara.

Krahasuar me vitin 2018, rezulton se ka një rritje të konsiderueshme të treguesve në këtë drejtim.



III.2.2 Inspektime të Planifikuara

Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar **10 inspektime të planifikuara**. Gjatë këtyre inspektimeve është kontrolluar veprimtaria e **29 strukturave** duke dhënë **71 rekomandime** për përmirësimin e performancës, rishikimin e procedurave standarde si dhe rekomanduar fillimin e hetimit disiplinor për **170 punonjës policie**.

Inspektimet u kryen në DVP Shkodër, Tiranë, Durrës, Lezhë, Fier, Durrës, Gjirokastrë dhe Vlorë si dhe DVKM Girokastrë.

Objekti i inspektimeve në DVP ishte evidentimi i:

- “Veprimtarisë së SPZ dhe veprimtarisë në lidhje me parandalimin e goditjen e veprave penale për ndërtimet e paligjshme, të raportuara në Komisarriatit Dixhital”;
- “Veprimtarisë së strukturave të Drejtorive Vendore të Policisë, në lidhje me sensibilizimin, monitorimin dhe parandalimin e kultivimit të lëndëve narkotike”;
- “Veprimtarisë së punës me dosjet hetimore të pezulluara, dosjet e informatave dhe dosjet e personave në kërkim në strukturat e hetimit për krimet e rënda”;
- “Veprimtarisë së OASH-së”;

- “Procedurave të kalimit në kufi të shtetasve të mitur”;
- “Zbatimit të procedurave për personat e kthyer në kategoritë *Deportiv dhe INAD*”;
- “Zbatim të procedurave të kontrollit të kufirit në kuadër të parandalimit të kalimit të paligjshëm të kufirit”.

III.2.3 Inspektime të Paplanifikuara:

Gjatë vitit 2019 u realizuan **20 inspektime të paplanifikuara**, të cilat u iniciuan nga ngjarjet e ndodhura, publikimet në media dhe problematika të raportuara nga qytetarë ose institucione të ndryshme.

Gjatë këtyre inspektimeve është kontrolluar veprimtaria e **87 strukturave** duke dhënë **73 rekomandime** për përmirësimin e performancës, rishikimin e procedurave standarde si dhe rekomanduar fillimin e hetimit disiplinor për **97 punonjës** policie e **5 punonjës** të strukturave të Ministrisë së Brendshme, e konkretisht:

III.2.4 Inspektime për Trajtim Ankesash:

Gjatë periudhës raportuese janë trajtuar **43 ankesa**, në përfundim të hetimit administrative të kryer rezultojnë se:

- Në **34** raste pretendimet e ngritura nuk qëndrojnë, pasi veprimet e punonjësve të policisë kanë qenë konform procedurave standarde të punës.
- Në **9 raste për 14 punonjës** është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor për punonjës dhe strukturën përkatëse të policisë, përgjegjëse për shkeljen/shkeljet e pretenduara dhe të evidentuara.

IV. VEPRIMTARIA E STRUKTURAVE TË DREJTORISË SË HETIMIT PENAL

Në funksion të vënies në efikasitet të strukturave të hetimit të Shërbimit, dy dokumentat bazë të planifikimit, menaxhimit e drejtimit “*Programi Vjetor dhe Plani Vjetor i Punës*” u zbërthyan në Plane konkrete Veprimi, në fushën e veprimitarisë informativo-gjurmuese, hetimore dhe asaj operacionale. Në këtë drejtim u hartuan dhe miratuan **5 akte normative** të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit.

Krahas, përmirësimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor që normojnë veprimtarinë e strukturave hetimore të Shërbimit, por dhe për të patur një vlerësim real e konkret të situatës në strukturat vendore të Shërbimit, **u kryen 6 inspektime në Drejtoritë Rajonale të SHÇBA-së**. Në zbatim të protokolleve të inspektimit u “Evidentuan, analizuan dhe vlerësuan treguesit nominale të punës për çdo punonjës për periudhën 6-mujore të vitit 2019”, konstatimet dhe problematikat u pasqyruan në Raportet e Inspektimit me rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda muajit Shtator të 2019.

Bazuar në orientimin dhe drejtimin e veprimitarisë së Strukturave të Hetimit të Shërbimit, drejt problematikave kryesore apo fenomeneve të evidentuara në rradhët e strukturave, subjekte të Shërbimit, në veçanti të Policisë së Shtetit, për paligjshmëri dhe abuzim me detyrën, bazuar në treguesit e vitit 2018, por dhe nga vetë raportet vjetore të strukturave vendore dhe qëndrore të Policisë, gjatë vitit 2019, nga strukturat e Hetimit të Shërbimit, janë nxjerrë konkluzionet e mëposhtme sa i përket fenomeneve të konstatuara:

IV.1 Fenomenet

Fenomeni i shpërdorimit të detyrës

Është fenomeni më tipik dhe më i përhapur, që zë rreth 57 % të totalit të veprimtarisë së kundërligjshme. Format më kryesore që ai shfaqet janë;

- Shpërdorim detyre i lidhur me korrupsionin pasiv ose aktiv.
- Shpërdorim detyre, me veprim apo mosveprim në favorizimin e kultivimit të bimëve narkotike apo trafikimit të saj.
- Shpërdorim detyre, me veprim apo mosveprim në favorizimin e ndërtimeve pa leje

Aktet Korruptive

Edhe ky fenomen është tepër i gjerë dhe i shtrirë në zinxhirin komandues. Në totalin e tij ai zë 19 %. Kjo formë e veprimtarisë së kundërligjshme është evidentuar më gjerësisht në strukturat e policisë së qarkullimit rrugor, të kufirit por edhe në ato të rendit dhe të hetimit të krimit.

Ndërsa nëpërmjet të dhënave/informacioneve të siguruar në rrugë operative dhe ndjekjes me hetime proaktive, janë rastet e dyshuara të kërkim/marrjes së “rryshfetit” me qëllim:

- favorizimin e personave të ndaluar/shoqëruar;
- krijimin e favorizimeve për të mos kryer një detyrë të caktuar;
- në fshehjen e informacioneve mbi situatën apo për personin konkret;
- në dekonspirime të veprimeve policore;
- për lidhje me persona me precedent kriminal e penal por në raste të veçanta edhe grupeve të strukturuar kriminale;
- në favorizimin e paligjshmërisë dhe mosndëshkimin e individëve apo subjekteve të ndryshme private siç; janë mosdhënia ose shtrëngimi për dhënien e së drejtës ndaj qytetarit për një licensë, për një autorizim, për rastet e lirimit të një makine të bllokuar, etj.

Veprimtaria e paligjshmërisë në Kufirin Shtetëror.

Kjo formë e veprimtarisë së kundërligjshme evidentohet me një trend shtrirje në të gjithë strukturat e policisë kufitare, më e shpeshtë në Pikat e Kalimit Kufitar tokësor, nga punonjës të nivelit zbatues (kontroll e ndihmës kontrollor) por edhe në nivele të para të menaxhimit (përgjegjës turni, komandant stacioni policor etj).

Format më tipike të veprimtarisë së kundërligjshme në kufirin shtetëror, janë:

➤ Favorizimi i kalimit të paligjshëm të kufirit nga shtetas të huaj dhe shqiptarë, që kryhet nëpërmjet:

- Kalimit pa rregjistruar në sistem të personave të kthyer si persona INAD dhe DEPORTIV nga vendet e zonës Shengen, kundrejt pagesës;
- Rregjistrimit në sistem të personave të kategorive të sipërcituara, me të dhëna të rreme;
- Vendosije fiktive të vulave dhe rregjistrime të hyrje – daljeve në sistem;
- Kalimit të shtetasve të mitur të pashoqëruar, vetëm nga njëri prej prindërve dhe pa deklaratë noteriale, kundrejt pagesës;
- Lejimit të kalimit të kufirit të gjelbër kryesisht nga shtetas të huaj (nga vendet e lindjes së mesme) por edhe shqiptarë, duke mos ushtruar kontroll territori, në bashkëpunim me trafikantët, kundrejt një pagese në shumicën e rasteve “tarifë për kalesë por edhe mujore”.

- Favorizimi i kalimit të bimëve/lëndëve narkotike, si në Pikat e Kalimit Kufitar ashtu edhe nëpërmjet Kufirit të Gjellbër dhe atij Blu, i cili kryhet:
 - Nga strukturat kryesisht të vijës së dytë të kontrollit, të cilët abuzojnë me kontrollin e automjeteve të vogla ose kamionëve dhe shkaktojnë vonesa në dërgimin e tyre në zonën e skanerit;
 - Në pikat e kalimit kufitar, kryesisht në zona të thella të kufirit tokësore, ku kontrollet e territorit janë të pakta ose inekziste.
- Favorizimi i kontrabandës me mallra të akcizës dhe mallra të tjerë, që kryhet nëpërmjet:
 - Lejimit të kalimit të mjeteve që fusin mallra të akcizës apo mallra të padeklaruara pa kryer veprimet doganore;
 - Nga strukturat kryesisht të vijës së dytë të kontrollit, të cilët abuzojnë me kontrollin e automjeteve të vogla ose kamionëve, që transportojnë mallra të akcizës apo mallra të tjerë dhe shkaktojnë vonesa në dërgimin e tyre në zonën e skanerit;

Veprimtari të kundërligjshme të kryera nga vetë subjektet e Sherbimit.

Nga hetimet, inspektimet, trajtimet e ankesave por dhe nga vrojtimit me plane konkrete ka rezultuar se një pjesë e mirë e anëtarëve të organizatës së policisë, here me dashje direkte herë në formën e qëndrimit të pakujdesshëm, abuzojnë me pozicionin e tyre duke krijuar imazhe të rënda në publik.

Forca dhe shpejtësia reaguese/vepruese e strukturave në raste ngjarjesh

Nisur nga analizimi i ankesave/denoncimeve kryesisht të këtyre viteve të fundit, ku trendi i shkeljeve të pretenduara mbetet pothuajse i njëjtë dhe në krye të tij qëndron “mosveprimi i strukturave” dhe “shkelje ose mospërbushje të procedurave standarde të punës”, në trajtimin dhe zgjidhjen e konflikteve të llojeve të ndryshme në jetën komunitare, u ndërmor nga ana jonë edhe “Monitorimi i Strukturave të Policisë së Shtetit në lidhje me Reagimin dhe veprimet e tyre, për raportimet/njoftimet në Komisarati Digital dhe numrat e emergjencës (129,126 dhe 112)”.

Telefonatat dhe raportimet e bëra nga ana jonë i përkisnin rasteve të konstatuara dhe situatave të improvizuara në lidhje me:


- Parkim i gabuar;
- Aksidente rrugore
- Shkaktim zhurme
- Konflikt/rrahje
- Ndërtim i paligjshëm
- Zjarrëvënie

U monitoruan 55 raste të të raportuara nga punonjësit e shërbimit në numrat e emergjencës 129, 126 dhe 112 si dhe në aplikacionin Komisarati Digital, lidhur me reagimin dhe veprimet e strukturave të policisë, nga ku rezultoi se:

- Në 40 raste ose 73% të tyre janë zbatuar procedurat standarde të punës dhe reagimi i strukturave policore ka qenë korrekt dhe i shpejtë,
- Në 15 raste ose 27 % të tyre nuk janë zbatuar procedurat standarde, është vajtur me vonesë apo nuk ka pasur reagim në lidhje me raportimet e bëra.

IV.2 Hetimi procedural penal

Duke u bazuar tek analiza e informacioneve të administruara nga shumë burime, të përfuara nga vetë Shërbimi, por dhe të ardhura nga shtetas fizik e subjekte private e publike, është bërë e mundur çelja e shumë hetimeve penale, administrative ndaj ankesave dhe kryerjes së inspektimeve. Teju kryesor kanë qënë hetimet proaktive informativo - gjurmuese duke përdorur metoda speciale të hetimit dhe ato të referuara e të deleguara për përfundim të tyre nga strukturat tona.





Këta tregues statistikor të këtij viti krahasuar me ato të vitit 2018, paqyrojnë një rritje të konsiderueshme sasiore dhe cilësore të veprimtarive kryesore të Shërbimit, konkretisht vlerësojmë një:

- Rritje me **78 % të numrit të subjekteve të proceduar**,
- Rritje me **149 % të numrit të subjekteve** ndaj të cilëve është marrë masa sigurimi personal si; *arreste/ndalime ose pezullime nga ushtrimi i funksioneve*, etj,
- Rritje me **136 % të hetimeve proaktive**,
- Rritje me **49 % të hetimeve procedurale penale e ato administrative**, të ndjekura.

Të gjithë këta tregues flasin për një punë tepër voluminoze, punë serioze dhe kontribut real në realizimin e misionit ligjor dhe objektivat kryesore të veprimtarisë së Shërbimit.

❖ Grafik krahasimor me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar






IV.3 Disa nga operacionet për zbulimin dhe goditjen e “kultivimit” dhe shkeljeve të tjera nga punonjës të strukturave:

- Strukturat e hetimit kanë zhvilluar 4 operacione të drejtuara dhe realizuara në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit për kultivimin e bimëve narkotike, ku janë goditur subjekte policore të dyshuar për shpërdorim detyre, qëndrime korruptive apo favorizim në kultivimin e bimëve narkotike.

Rezultatet e arritura		
19.583	1268	300
<i>rrënjë bimë narkotike të gjetura dhe asgjësuara</i>	<i>fidanë në kubik</i>	<i>bimë të thara, armë e municione</i>

- *Pjesmarrje në operacionet policore për kontroll territori, me strukturat e Policisë së Shtetit, konkretisht:*
 - *Njësia Administrative Gorë, Bashkia Maliq*
 - *Zona ndërmjet fshatrave Sopot – Zavalinë, Elbasan*
 - *Njësia Administrative Orenjë, Librazhd*
 - *Njësia Administrative Selitë, Mallakastër*
 - *Njësia Administrative Qëndër dhe Gjerbes, Skrapar*

Rezultatet e arritura
5284 rrënjë
<i>bimë narkotike të gjetura dhe të asgjësuara</i>



V. VEPRIMTARIA E SHÇBA NË FUSHËN E VERIFIKIMIT TË PASTËRTISË SË FIGURËS

SHÇBA ka organizuar e ndjekur punën për procesin e verifikimit të praktikave në kuadër të:

- Aplikimit të personave me Certifikatë të Sigurimit të Personelit,
- Procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve/prokurorëve sipas ligjit 84/2016,
- Procesit të rivlerësimit të strukturave sipas ligjit 12/2018, i ndryshuar,
- Procesit të verifikimit të kandidatëve për strukturat e reja të drejtësisë, sipas ligjit 96/2016.

V.1 Mbikqyrja nëpërmjet veprimtarisë së Vettingut

Përgjegjësia ligjore dhe funksionale e Shërbimit, si një nga tre Autoritetet Verifikuese në vend, mbi pastërtinë e figurës së subjekteve të strukturave, objekt i veprimtarisë së Shërbimit, e jo vetëm si dhe vlerësimit dhe gjykimit mbi indikatorin e “besueshmërisë” dhe nivelit të tij për ecurinë e mëtejshme në karrierë, e ka angazhuar SHÇBA, në dy procese thelbësore, që po ndodhin sot në vendin tonë.

- Vettingu në radhët e sistemit të drejtësisë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016
- Vettingu në radhët e strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe vetë SHÇBA-së sipas ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

Vettingu i prokurorëve dhe gjyqtarëve, si pjesë e rëndësishme e paketës së reformës në sistemin e drejtësisë në vendin tonë, e përfshiu Shërbimin në proceset thelbësore, në atë të angazhimit me përfaqësues në Grupin e Punës për Kontrollin e Figurës, ngritur dhe me funksionim pranë Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar “Sekret Shtetëror” dhe njëkohësisht në kryerjen e procedurave verifikuese për subjektet e rivlerësimit dhe “personat e lidhur” apo “persona të tjerë të lidhur” me ta.

Një proces i nisur ky në Gusht 2017, e që vazhdon akoma në të dyja drejtimet dhe me vlerësim pozitive të punës së bërë nga strukturat përkatëse të Shërbimit, në përballimin e një volumi të madh praktikash verifikuese.

Vettingu sipas ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, është një proces akoma më i rëndësishëm, pasi ne vetë si Shërbim, dhe personeli i tij, janë subjekte të këtij ligji dhe kanë përgjegjësinë morale dhe funksionale të llogaridhënies mbi të tre komponentët e vlerësimit (kontroll figure, pasurie dhe profesionalizëm). Ana tjetër e medaljes është përgjegjësia institucionale dhe funksionale që ky ligj i ka dhënë tashmë Shërbimit, si institucioni përgjegjës për “Vettingun kalimtar dhe periodik” për strukturat e Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës). Për këtë proces është hartuar dhe po zbatohet një program pune në të cilin janë parashikuar detyra dhe objektiva konkrete për realizimin e një procesi ligjor, transparent, të paanshëm dhe objektiv. Ky proces vlerësimi u parapri nga ana jonë me:

- Riorganizimin e ri strukturor të Shërbimit ku përvec të tjerash u konturua edhe Drejtoria e Vlersimit Kalimtar dhe Periodik
- Përgatitjen e procedurave administrative për rekrutimin e personelit të kësaj Drejtorie mbi bazën e përzgjedhjes, e testimit të tyre.
- Marrjen e masave organizative dhe teknike për akomodimin me poste pune të punonjësve të saj.
- Hartimin e njëserë akteve normative që do të rregullojnë veprimtarinë e strukturave të vlersimit kalimtar dhe periodik si dhe .
- Trajnimin e vazhdueshëm profesional të tyre.

Gjatë vitit 2019 me mbështetjen e Programit ICITAP, u ngrit edhe Sektori i Poligrafit i cili ka kompetencë kryerjen e ekzaminimeve Poligrafike si një risi e re e Shërbimit në kuadër të zbatimit të Reformës në Drejtësi. “Testit të Poligrafit” si një procedurë administrative e profesionale është në përputhje me dispozitat e ligjit “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuara (Ligji për SPAK-un) i vitit 2016”, të cilit do t’i nënshtrohen jo vetëm punonjësit e këtyre organeve por edhe të institucioneve të tjera ligjzbatuese. Procedurat e përzgjedhjes së personelit të këtij sektori, pajisja me materialet e nevojshme (kitet profesionale) për ekzaminimet poligrafike dhe trajnimi 2 mujor i tyre u realizua me ndihmën dhe mbështetjen e Programit ICITAP.

Në interes të Vettingut në Policinë e Shtetit e më gjerë, është forcuar së tepërmi marrëdhënia me institucionet ligjzbatuese si SHISH, DSIK, AISM, me vetë Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit, të cilëve i jemi përgjigjur në kohë të gjitha kërkesave të tyre, mbi vënien në dispozicion të materialeve që administrojnë SHCBA.

Sipas procedurës i gjithë produkti i përfituar nga trajtimi i praktikave certifikohet në kompetencë të DSIK për plotësim ose jo të kushteve të sigurisë dhe të ekzistencës së rrezikut të pranueshëm ose jo. Në këtë kontekst, janë vlerësuar për CSP rreth **1780 praktika**, për subjektet e Shërbimit dhe rreth **739 punonjës** të Operatorëve Ekonomik, apo **1387 punonjës** të Institucioneve Shtetërore.

Në përfundim të procedurave verifikuese nga ana e Shërbimit, për punonjësit e strukturave, objekt i veprimtarisë së SHCBA-së, janë adresuar pranë DSIK **127 raste** të vlerësuara “*që përbëjnë rrezik për pajisjen me CSP, të subjekteve të SHCBA-së*”, në kuadër të aksesit dhe njohjes me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”.

VI. VEPRIMTARIA E SHÇBA NË FUNKSION TË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE SEKTORI I FINANCËS

Në kuadër të ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave që ligji dhe rregullorja përcaktojnë për këtë drejtori, gjatë vitit 2019, veprimtaria e saj konstaton në:

VI.1 Rekrutimet, emërimet, transferimet, lirimet nga detyra

Në kuadër të implementimit të Strukturës dhe Përbërjes së re Organike të Shërbimit, janë ndjekur dhe zhvilluar;

Emërimet	<ul style="list-style-type: none">• 7 procedurë konkurimi për pranime të reja në Shërbim, me 69 kandidatë pjesmarrës, nga të cilët 39 kandidatë fitues• 26 prej të cilëve u emëruan në pozicionet vakante.• 1 transferim nga DAP (ngritje në detyrë)
Largime	<ul style="list-style-type: none">• 4 kërkesa për dorëheqje me dëshirë e punonjësve• 3 përjashtime nga Shërbimi si pasojë e masës së rëndë disiplinore
Transferime/komandime	<ul style="list-style-type: none">• 14 praktika transferimesh për punonjësit e Shërbimit• 1 komandim në detyrë për nevojë pune për 1 punonjës të Shërbimit

VI.2 Edukimi, trajnimi i personelit

Janë zhvilluar 20 trajnime/tryeza të përbashkëta ku kanë marrë pjesë 80 punonjës të Shërbimit. Këto aktivitete janë organizuar në bashkëpunim të ngushtë me Akademinë e Sigurisë, Policinë e Shtetit, partnerët tanë brenda dhe jashtë vendit si; ICITAP, PAMECA V, DCAF, EPAC, OSBE etj, me synim ngritjen profesionale dhe të kapaciteteve të brendshme të Shërbimit. Trajnimet/workshop-et apo tryezat e përbashkëta janë fokusuar në tematikat që lidhen me hetimin e krimit, analizën e informacionit kriminal, mjetet dhe mekanizmat e përdorura për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, për çështje që lidhen me etikën, integritetin profesional dhe moral, etj.

VI.3 Masat disiplinore

- Praktikë shkresore për hetimin disiplinor ndaj 32 punonjësve të SHÇBA-së:
 - 22 masa të lehta, nga të cilat:
 - 21 masa disiplinore “Vërejtje”
 - 1 masë disiplinore “Vërejtje me shkrim”
 - 10 masa të rënda, nga të cilat:
 - 3 masa disiplinore “Ulje në gradë, pa të drejtë konkurimi për 2 vjet”
 - 3 masa disiplinore “Shtyrje e afatit të gradimit për 12 muaj”
 - 1 masë disiplinore “Heqje e 5 ditëve pune”
 - 3 masa disiplinore “Përjashtim nga Shërbimi”

VI.4 Ecuria në karrierë (gradë)

- Praktikant shkresore për procedurat e “ngritjes në gradat Inspektor i Parë, K/Inspektor e Drejtues i Shërbimit”, konkretisht:
 - 3 kandidatë për “*Inspektor i Parë*” – të skualifikuar, nuk përmbushnin kriteret
 - 7 kandidatë për “*K/Inspektor*” – 4 të skualifikuar – **3 fitues**
 - 9 kandidatë për “*Drejtues*” – 4 të skualifikuar – **5 fitues**

VI.5 Sektori i Buxhet-Financës

Në total shpenzimet me çelje buxhetore për vitin 2019, për njësinë tonë, janë miratuar fonde në shumën prej 185,287,337 lekë, nga të cilat janë realizuar fondet në shumën 178,259,095 lekë ose në masën 96%.

Më poshtë jepet pasqyra e fondeve të planifikuara dhe realizuara përkatësisht sipas zërave buxhetor, për vitin 2019.

Tabela Nr.1

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Plani</i>	<i>Realizimi</i>	<i>Diferenca</i>	<i>Real. në %</i>
1	Paga & shpenz. personeli	123,500,000	120,690,805	2,809,195	98%
2	Sigurime shoqerore	20,900,000	19,999,237	900,763	96%
3	Mallra e shërbime	22,850,000	19,919,251	2,930,749	87%
4	Transf.buxhetet familjare	7,037,337	6,658,210	379,127	95%
5	Investime	11,000,000	10,991,592	8,408	100%
TOTALI		185,287,337	178,259,095	7,028,242	96%

VI.6 Aktivitete brenda dhe jashtë vendit të SHÇBA

VI.6.1 Angazhime dhe aktivitete brenda vendit

- Në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në Planin Vjetor të Marrëdhënieve me Publikun të SHÇBA-së për vitin 2019, janë zhvilluar fushata promovuese në pesë (5) qarqe të vendit (*Vlorë, Korçë, Elbasan, Shkodër dhe Lezhë*). Gjatë këtyre fushatave janë zhvilluar takime me nxënës, studentë dhe qytetarë të ndryshëm në:
 - 6 shkolla të mesme
 - 4 Universitete
 - 4 pika kufitare
 - 5 DVP (*Vlorë, Korçë, Elbasan, Shkodër dhe Lezhë*)
 - 2 Prefektura (*Shkodër dhe Lezhë*)
 - 2 takime në bashkëpunim me OJF

Gjatë fushatave promovionale janë shpërndarë:

- 200 Broshura
- 2000 Fletëpalosje
- 2000 kartvizita

Gjatë këtyre aktiviteteve është vënë theksi tek rritja e bashkëpunimit Shërbim-publik si një element kyç në funksion të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë, së pari duke nisur nga vetë SHÇBA dhe duke vijuar më pas tek subjektet që janë objekt i veprimtarisë sonë. Për këtë arsye, qytetarëve i janë bërë të ditura të gjitha mjetet dhe mënyrat e komunikimit që Shërbimi ka vënë në dispozicion për publikun në kuadër të ankesave që ata mund të kenë ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, apo shërbimit Zjarrfikës.

Takimet kanë qenë të hapura dhe mjaft të suksesshme në kuadër të marrëdhënieve transparente me publikun edhe për faktin se ato janë pasqyruar gjerësisht nga mediat e shkruara, elektronike dhe audio-vizive, në nivel kombëtar dhe lokal.

Për më tepër, gjatë vitit 2019, Shërbimi ka rikonceptuar faqen zyrtare të tij në internet duke i mundësuar përdoruesve më tëpër lehtësi në kërkimin e informacionit, i cili publikohet në kohë reale dhe i plotë, në funksion të transparencës me qytetarët.

VI.6.2 Angazhimi në aktivitete jashtë vendit

- Gjatë vitit 2019, SHÇBA u përfaqësua dhe mori pjesë në takimin e 11-të të N/Komitetit për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Bashkim Evropian – Shqipëri.
- SHÇBA, u përfaqësua në Vienë, Austri, në takimin e parë të grupit të punës të Oganizmave të Mbikqyrjes së Jashtme Policore dhe Agjencive Anti-Korrupsion të rrjetit të Vendeve Partnere Europiane Kundër Korrupsionit (EPAC) me tematikë “*Integriteti dhe standardet anti-korrupsion të BE-së*”. Ky takim i parë, që do të pasohet edhe nga të tjera takime pune dhe shkëmbim eksperiencash dhe informacionesh mes vendeve pjesëmarrëse, synon hartimin e një “Manuali mbi integritetin dhe standardet e përbashkëta anti-korrupsion” që do të shërbejë gjatë veprimtarisë së tyre, për të gjitha vendet anëtare të këtij rrjeti.
- Shërbimi u përfaqësua dhe anëtarësua në Platformën Rajonale Anti-Korrupsion për Departamentet e Kontrollit të Brendshëm të Agjencive Ligjzbatuese dhe të Kufirit të vendeve pjesëmarrëse të Ballkanit Perëndimor, të OSBE-së e të Moldavisë dhe Ukrainës, krijuar në **Shtator 2019**.

VII. PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT PËR VITIN 2020

Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në kuadër të prioriteteve të Programit të Qeverisë Shqiptare 2017 – 2021, për Ministrinë e Brendshme; do të ketë për një periudhë pesë vjecare prioritetet dhe objektivat të parashikuara në dokumentin strategjik të Shërbimit 2020 -2024.

Gjithsesi veprimtaria që përbën sfidë për SHÇBA, mund të sintetizohet në; “*Efiçencën për të mbikqyrur ushtrimin e autoritetit Policor të organeve të tjera ligjzbatuese dhe parandaluar shkeljet e ligjshmërisë e korrupsionin; me qëllim që të mbrohen gjithnjë e më mirë të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve*”.

Lufta kundër paligjshmërisë dhe korrupsionit në veprimtarinë e organeve, nuk duhet kuptuar e fokusuar vetëm tek ndryshimet ligjore, apo punonjësit e veçantë që abuzojnë në polici, por tek zhvillimi i standardeve të organizatës dhe policimit, duke forcuar integritetin e kombinuar masat parandaluese me ato shtrënguese, si dhe bashkërenduar veprimet me institucionet e tjera shtetërore, ato të drejtësisë e komunitetin.

Në këtë kuptim, bazuar në analizën e mësipërme, gjetjet, rekomandimet dhe reformat që e presin zhvillimin institucional të Shërbimit, për vitin 2020, parashikohen dhe përcaktohen si synime prioritare;

1. Forcimi i integritetit të strukturave ligjzbatuese me objektiv;

- Qasja moderne për të përmirësuar integritetin e policisë.
- Zhvillimi i procesit të Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik të punonjësve, për të mbrojtur e pasuruar më tej vlerat dhe integritetin e organeve dhe punonjësve, sipas kritereve e procedurave të përcaktuara në legjislacion.

2. Zhvillimi i standardeve të SHÇBA, për të krijuar një shërbim publik që funksionon mbi bazën e ligjit dhe parimeve demokratike; të hapur, dinamik, të besueshëm, efikas dhe eficient, transparent e kontrollueshëm, me objektiv:

- Përmirësimi i infrastrukturës ligjore e organizative (ligjit organik të SHÇBA, akteve të tjera nënligjore, organizimit e funksionimit të Shërbimit) dhe përafrimi me ato të vendeve perëndimore, për të rritur efektivitetin e Shërbimit dhe përmbushur misionin e ngarkuar.
- Sigurimi i burimeve të duhura (njerëzore, materiale e teknologjike), për të krijuar kushtet e nevojshme dhe motivuar punonjësit në kryerjen e detyrave.

3. Përmirësimi i drejtimit dhe bashkëpunimit me organet që janë objekt i veprimtarisë; opinionin publik dhe aktorë të tjerë shtetërorë, shoqërorë, e të sipërmarrjes së lirë me objektiv;

- Përmirësimi i menaxhimit të Shërbimit në të gjitha nivelet për të siguruar një Shërbim efikas dhe transparent për të menaxhuar burimet dhe motivuar punonjësit në kryerjen e detyrave.
- Forcimi i bashkëpunimit me organet që janë objekt i veprimtarisë së Shërbimit dhe punonjësit e tyre; organet e agjencitë e tjera publike dhe ato homologe të rajonit e më gjerë.
- Forcimi i bashkëpunimit me publikun; median; organizma të shoqërisë civile, sipërmarrjen e lirë dhe qytetarët, për të rritur besimin e mbështetjen në kryerjen e detyrave.

4. Rritja e performancës së shërbimit, për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e shkeljeve të ligjit, korrupsionit e veprave të tjera penale në radhët e punonjësve të organeve, për të mbrojtur integritetin e veprimtarinë e rregullt shtetërore dhe të drejtat e liritë themelore të shtetasve me objektiv.

- Sigurimi i informacionit duke përdorur të gjitha burimet dhe mjetet e mundshme ligjore dhe administrimi i tij për njohjen e gjendjes, parandalimin e zbulimin e veprave korruptive.
- Trajtimi i ankesave të qytetarëve dhe subjekteve të ndryshme, me objektivitet e transparencë.
- Inspektimi i strukturave ligj zbatuese, për të parandaluar shkeljet ligjore në ushtrimin e autoritetit dhe kompetencave të dhëna nga ligji.
- Hetimi i shkeljeve të ligjit, korrupsionit dhe veprave të tjera penale të kryera nga punonjës të organeve shtetërore që janë objekt i veprimtarisë së Shërbimit

SHËRBIMI PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAVE